



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.09.2018 ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 24 shtator – 12 tetor 2018.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Ilir Beqaj -	Zëvendëskryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim /Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Fatmir Mediu - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Albana Vokshi - Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Genc Pollo - Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian

Marrin pjesë:

Mimoza Pano - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Hapim këtë mbledhje të Konferencës së Kryetarëve me rend dite, mirarimin e kalendarit 3-javor të Kuvendit për periudhën 24 shtator – 12 tetor 2018. Me projektkalendarin jeni njohur paraprakisht në mënyrë elektronike, ku në të përfshihet veprimtaria në komisione dhe në seancë plenare. Njoftoj Konferencën e Kryetarëve se nga Qeveria është depozituar projektligji “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues, miratimin e përjashtimeve nga tatimet dhe taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen”, i cili është në urgjencë miratimi, që sigurisht do të përfshihet. Seanca e datës 27 shtator do të zhvendoset në datë 24 shtator ora 10.00 dhe më pas vazhdojnë datat 4 tetor e enjte ora 10.00 dhe 11 tetor e enjte ora 10.00. Në lidhje me kalendarin ka ndonjë sugjerim nga kryetarët e komisioneve?

Ermonela Felaj – Shoh që në kalendar është vendosur nisma “Për ndryshimin e Kodit Penal” dhe, në mos gabo, lidhet me mbrojtjen e kafshëve nga dhuna e njerëzve. Por ka dhe një nismë tjetër që ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve për shkak se nuk i mbajnë kafshët në mënyrën se si duhet dhe besoj se kjo është dhe më problematike. Do të kishte më shumë sens që të bënim këtë hap të parë dhe më pas nismën tjetër, shikoj që është planifikuar edhe për në seancë.

Gramoz Ruçi – Janë dy projektligje?

Ermonela Felaj – Kanë qenë dy nisma në Kuvend ku njëra mbron njerëzit nga kafshët dhe tjetra që mbron kafshët nga dhuna e njerëzve.

Ulsi Manja – Kanë qenë dy nisma, ku njëra është nismë deputeti dhe normalisht duhet ridepozituar dhe një nismë tjetër me firmat e mbi 20 mijë zgjedhësve.

Mimoza Pano – Nisma që thotë Kryetarja e komisionit të Sigurisë është nisëm e depozituar drejtëpërdrejtë nga mbi 30 mijë zgjedhës, që kanë depozituar në Kuvend nismën dhe firmat, sipas dokumentit të identifikimit. Edhe kjo nismë, si të gjitha nismat e tjera, duhet t'i nënshtrohet procedurave parlamentare, sikurse kemi vepruar edhe me praktikën e mëparshme parlamentare për nismën “Për disa masa ndaj dhunës në familje”, e cila ka qenë nisëm e mbi 20 mijë zgjedhësve. Ndërsa nisma tjetër, që ka pasur pak a shumë të njëjtin objekt, ka qenë nismë e një deputeti “Për ndryshimin e Kodit Penal”, ka qenë deputeti Saimir Tahiri që e ka depozituar me firmën e tij. Në momentin që ai ka lënë mandatin nisma e tij bie dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedurave parlamentare. Faktikisht ajo nuk është më pjesë e programit të punës së Kuvendit. Nëse rimerret nga deputetë të tjerë sërish, ajo do të bëhet pjesë e programit dhe kalendarit të punimeve të Kuvendit.

Gramoz Ruçi – Në mos gaboj zonja Felaj tha të kundërtën, që nisma për mbrojtjen e kafshëve është për mbrojtjen e kafshëve.

Mimoza Pano – Bëhet fjalë për nismën e zgjedhësve, sepse vetëm atë mund tia nënshtrojmë në procedurave parlamentare, pra këtë që kemi në kalendar. Nismën e zgjedhësve.

Gramoz Ruçi – Të vazhdojë rrugën nisma atëherë. Ndërsa për nismën e deputetit që të hyjë në praktikën parlamentare duhet ta marrë një deputet tjetër si nismë ose rrëzohet. Tjetër?

Erion Braçe – Zoti Kryetar, e shikoj prej muajsh të tërë këtu në kalendar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013, “Për konçensionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar, nismë e Këshillit të Ministrave. Në dijeninë time, Qeveria ka përgatitur një ligj të plotë për konçensionet dhe partneritetin publik privat, që është në proces konsulti dhe të tjera me radhë. Tani Qeveria ta tërheqë këtë nismë, për sa kohë që do të sjellë një ndryshim të plotë, pasi kjo është ndryshim vetëm për një nen. Të tërheqë këtë ekzistuesen për sa kohë që do sjellë ligjin e plotë, pasi nuk ka sens.

Senida Mesi – Është e vërtetë kjo që thotë zoti Braçe. Unë i kam kërkuar dhe Sekretarit të Përgjithshëm që në kuadër të nismës të vijë në mënyrë më të zgjeruar për të gjithë ligjin të referuar në fjalë. Të tërhiqet dhe do interesohem që të vijë edhe në mënyrë shkresore pranë Kuvendit nga të dy sekretarët e përgjithshëm si të Kuvendit edhe të Këshillit të Ministrave, me qëllim që të vijë dhe shkresa zyrtare. Ka dakordësi midis palëve. Nga ana ime është diskutuar edhe me zotin Braçe, është komunikuar paraprakisht dhe presim të finalizohet edhe në rrugë shkresore.

Vasilika Hysi – Faleminderit zoti Kryetar. I kërkoj ndjesë Kryetarit të komisionit, por shoh në kalendar disa ligje që lidhen me Reformën në Drejtësi dhe janë parashikuar të shqyrtohen në seancë plenare në datën 24 shtator. Është ligji “Për noterinë”. Në datë 4 tetor shoh ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Në dijeninë time këto janë ligje voluminoze, kanë shumë punë dhe nuk mund të kalojnë vetëm me një apo dy mbledhje, kjo për shkak edhe të rëndësisë së tyre.

Për ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ligji është në paketë me ligjin “Për shërbimin e provës” dhe me ligje të tjera. Data 4 tetor mendoj se është pak herët, të njëjtin shqetësim kam edhe për ligjin “Për përmbarimin gjyqësor”, i cili ka shumë ndryshime dhe do të ishte mirë që të kalonte brenda tetor – nëntorit të kësaj legjislature, t’i japim kohë diskutimit. Kur kemi pritur 2 vjet për të marrë opinionet e Ministrisë së Drejtësisë apo të partnerëve ndërkombëtarë, të paktën si relatore dhe si propozuese ligjesh dhe anëtare komisioni të kishim të paktën më shumë se dy mbledhje diskutim për këto projektligje. Faleminderit.

Ulsi Manja – Lidhur me atë çka tha zonja Hysi jam dakord që këto projektligje janë voluminoze, por komisioni i Ligjeve nuk ka më asnjë minutë kohë të presë. 2 vjet, 6 projektligje për komente që priten të vijnë nga Ministria e Drejtësisë apo aktorë të tjerë të shoqërisë civile.

Kam pasur një takim me shefen e misionit të EURALUS-it, e cila ka shprehur gatishmërinë që ekspertët e këtij misioni i kanë dhënë të gjitha komentet për këto projektligje, por ka dy vjet që ka një kakofoni mendimesh juridike dhe vetëm për draftin e përmbarimit privat janë dhënë 5 drafte alternative. Tani, me përgjegjshmërinë që më jep detyra që mbaj, këto projektligje do të kalojnë sipas këtij kalendar dhe programi që ka miratuar Kuvendi. E rëndësishme është që ligjet që do të miratojmë të certifikohen nga misioni i Bashkimit European, sepse në fund të fundit, këto projektligje me ata po i përputhim. Prandaj ndoshta nuk i kapim dot datat në seancë plenare për të gjitha, por që do të jenë pjesë e këtij kalendar kjo nuk diskutohet. Duhet t’i kishim miratuar që në sesionin e kaluar por pritëm që të vinin komentet, dhe komente deri tani ka sjellë vetëm misioni i EURALUS-it.

Lidhur me ligjin “Për ekzekutimin e veprimeve penale” është shumë e vërtetë që ka qenë paketë dhe me dy projektligjet e tjera “Për trajtimin e të dënuarve me burgim”, në mos gabo. U kërkuar në fillim të kësaj legjislature që Ministria e Drejtësisë të merrte të tre këto projektligje të paketës për t’i parë, meqenëse lidhen me sistemin e burgjeve dhe me trajtimin e të dënuarve me burgim, por siç i mori si paketë, deri tani nuk kemi asnjë reflektim. Po për sa kohë që ligji “Për ekzekutimin e veprimeve penale”, ku kërkon të reflektohen disa ndryshime

që i janë bërë “Kodit të Procedurës Penale”, në kuadrin e paketës për Reformën në Drejtësi është në program ,dhe do të duhet ta heqim edhe këtë sepse është thjesht një reflektim i ndryshimeve ligjore që ka pësuar legjislacioni jonë. Më pas me dy ligjet e tjera kur të bëhen në formë paketë ...

Gramoz Ruçi – Edhe një herë që ta marr vesh unë. Këta dy institucionet kryesore të partnerëve ndërkombëtarë kanë sjellë komentet e tyre këtu?

Ulsi Manja – Për ligjin e “Përmbartimit privat” dhe “Noterisë” po. Edhe ligji “Për strategjinë e edukimit ligjor”, madje ka qenë i përfunduar, sipas relatores zonjës Hysi. Që në sesionin e kaluar i kanë sjellë komentet, për të tjerat janë në proces dhe po punohet. Për këto të dyja, i kanë sjellë.

Gramoz Ruçi – Atëherë me këto të dyja të ecet në komision, por në asnjë mënyrë, komisionet të ecin pa siguruar mendimin e tyre. Ministria e Drejtësisë nuk ka komente, është dakord me projektin apo çfarë thotë?

Ulsi Manja – Ministria e Drejtësisë i ka marrë të gjitha projektligjet e reformës, në fakt për të bërë oponencën dhe komentet e veta që në fazën e shqyrtimit në komision të ecnin, të avanconim dhe të mos ngeleshim peng i neneve të caktuara, kjo ka qenë në bashkëpunim edhe me misionin e EURALUS-it. Misioni i EURALUS-it rakordon punën me Ministrinë e Drejtësisë dhe sipas asaj që më ka transmetuar mua për një pjesë të projektligjeve i ka dërguar komentet e veta pranë Ministrisë së Drejtësisë, sigurisht edhe pranë nesh. Ndërkohë Ministria e Drejtësisë edhe tani që flasim po punon për sjelljen e komenteve por nuk ka sjellë asgjë, me përjashtim të ligjit “Për përmbartimin privat”

Gramoz Ruçi – Atëherë zonja Zëvendëskryeministre i thuaj se në axhendën e Parlamentit nuk mund të qëndrojnë 7, 8 ligje që po mbarten e po mbarten dhe po flasim për Reformën në Drejtësi. Kjo punë duhet të eci dhe nuk duhet të bëhet pengesë Ministria e Drejtësisë për të dhënë opinionet e veta, ashtu sikurse ne duhet t’i kërkojmë me emergjencë që të dy këto institucione që kanë monitoruar dhe kontribuar për paketën ligjore të Reformës në Drejtësi.

Sic kanë sjellë komentet e tyre për dy projektligje që Ju sapo thatë, të sjellin dhe komentet edhe për të tjerat, dhe njëherësh komisioni të eci.

Mendoj që kërkesa e zonjës Hysi është e drejtë. Në datën 24 shtator të hiqet, pasi do të bëjmë seancë dhe nuk mund të bëhet mbledhje komisioni, po kështu dhe e mërkura të mos

zihet, pra data 26 shtator, pasi do të ketë mbledhje të përbashkët komisionit të Ligjeve dhe të Këshillit të Legjislacionit lidhur me nismën për Kushtetutën të opozitës e mbledhja do të zhvillohet në orën 12.00.

Eduard Shalsi – Shoh që është parashikuar diskutimi i projektligjit “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” për në datën 24 shtator, ndërkohë na duhet pak më shumë kohë. Ndërsa për ligjin “Për sektorin e gazit natyror” është gjithçka në rregull.

Gramoz Ruçi – Në lidhje me ligjin “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” ka vetëm një nen dhe ju mund ta shqyrtoni!

Eduard Shalsi – Po për një nen bëhet fjalë, por ka kolegë që kanë kërkuar të shtojnë disa gjëra dhe më duhet t’i pyes më përpara se ta konfirmoj. Kemi diskutuar që do ta ndryshojmë këtë ligj.

Gramoz Ruçi – Për të dy ligjet nga dy nene janë, prandaj nuk është ndonjë volum shumë i madh. Shikoni kalendarin e komisioneve për të enjten, apo të premten.

Tjetër, nuk ka, atëherë mbetemi dakord miratohet.

Vasilika Hysi – Kërkoj ndjesë por është Rregullorja e Kuvendit. Është parashikuar projektvendim “Për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit” që do bëjmë në datë 11 tetor. Në fakt në kemi tre raporte mbi të cilat duhet të punojmë për Rregulloren e Kuvendit.

E para është GRECO që kërkon të reflektohen lidhja e mirë midis “Kodit të Sjelljes” dhe “Rregullores së Kuvendit”

E dyta janë gjetjet e projektit IPA për rolin e Kuvendit në proceset e Integritetit Europian.

E treta janë ndryshimet në Rregullore që lidhen me nevojën për të reflektuar reformën që kemi bërë në Kushtetutë dhe në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Data 11 tetor mendoj se është jo realiste, sepse ne në radhë të parë duhet të punohet me të tëra amendamentet e Rregullores. Ne kemi edhe udhërrëfyesin për zbatimin e “Kodit të sjelljes” që duhet të miratojmë në Byro. Duhet të mblidhet Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetit dhe më pas të kalojë. Pra për një javë ne nuk i bëjmë të gjitha këto procese. Pra data 11 që është lënë është jo realiste. Edhe nga ana formale po ta shikosh, për 10 ditë të bësh kaq shumë ndryshime në një rregullore ...

Gramoz Ruçi – Por edhe duke mos vendosur afat e duke e shtyrë, e shtyrë vazhdimisht sikur nuk shkon.

Vasilika Hysi – Jo mund të vëmë afate, por të përkojnë me afatet që kanë vënë në planin e veprimit të BE-së që nuk është ky afat, por dhe në planin e veprimit të GRECO që nuk është ky afat. Ne tashmë kemi dy plane të miratuara.

Gramoz Ruçi – Ndryshojeni datën dhe vendoseni punë në komisione. Këtu e mbyllim, faleminderit.

MBLEDHJA MBYLLET